

VENDIM
Nr. 322, datë 31.5.2018

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 719, DATË 31.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijnë:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1 Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural organizohet në nivel qendror, nëpërmjet zyrës qendrore, dhe në nivel vendor, nëpërmjet agropikave."

2. Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

"5.1 Sportelet agropika kryejnë shërbime për fermerët dhe subjekte të tjera, personat fizikë e juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari bujqësore apo veprimtari të tjera ekonomike të lidhura me të në fushën e zhvillimit bujqësor, të industrisë agroushqimore e zhvillimit rural, dhe ofrojnë shërbime, si më poshtë vijon:

a) Informojnë dhe promovojnë programet e masat/skemat kombëtare të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural;

b) Informojnë dhe promovojnë programet dhe skemat e mbështetjes për bujqësinë e zhvillimin rural të financuara nga Bashkimi Evropian (IPARD II), si dhe donatorë të tjerë;

c) Japin informacion për fondet e garancisë dhe lehtësirat financiare që ofrojnë tregjet bankare e financiare për fermerët dhe subjektet e interesuara për mbështetje financiare në veprimtaritë e lidhura me zhvillimin bujqësor dhe rural;

ç) Ndërmjetësojnë marrëdhëniet me institucionet financiare dhe ato bankare lidhur me kreditë e refuzuara/ristrukturuara;

d) Japin informacion për legjislacionin për bujqësinë, veterinarinë, sigurinë ushqimore, agroturizmin, si dhe institucionet përgjegjëse rregullatore;

dh) Regjistrojnë të dhënat e fermës bujqësore e blegtorale sipas përcaktimeve ligjore për hyrjen e të dhënave në regjistrat përkatës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për *database* shtetërore;

e) Asistojnë aplikimet *online* apo në bazë dokumentesh për masat/skemat kombëtare, programet IPARD II, si dhe të projekteve të tjera komunitare të donatorëve të ndryshëm;

ë) Pranojnë aplikimet dhe raportojnë në vazhdimësi në sistemin e bazës të të dhënave të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në përputhje me afatet ligjore të miratuara për këtë qëllim, për mbështetjen financiare nga fondet e masave/skemave kombëtare;

f) Inspektojnë fermerët dhe subjektet përfituese të fondeve të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural."

3. Në fund të pikës 9 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Marrëdhëniet e punës së punonjësve të agropikave rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës."

4. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Struktura dhe organika e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Agropikat, në përbërje të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, krijohen si pjesë e urdhrit të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe të organikës së kësaj agjencie, sipas propozimit të ministrit.”.

5. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” dhe “ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” dhe “ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama